

UDHËZIM
Nr. 6251, datë 23.12.2016

PËR NDRYSHIMIN E UDHËZIMIT
NR. 4, DATË 21.5.2015,
“MBI PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, PROCEDURAVE DHE AFATEVE TË
VLEFSHMËRISË SË LICENCAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
TRANSPORTIT NDËRKOMBËTAR DETAR PËR AUTOMJETE DHE/OSE
UDHËTARË DHE SHKAQET E PROCEDURAT E PEZULLIMIT APO REVOKIMIT TË
TYRE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 401, pika “b”, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligji nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim përcaktimin më mirë të shërbimeve portuale që duhet të licencohen në fushat e transportit detar,

UDHËZOJ:

Ndryshimin e udhëzimit nr. 4, datë 21.5.2015, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre”, si më poshtë:

1. Në nenin 9 “Vërtetimi për kushtet teknike të anijes” bëhet këto ndryshime:

a) Tek emërtimi i nenit 9, pas fjalëve “...për kushtet...” fjala “teknike” të zëvendësohet me fjalën “e përgjithshme”...

b) Te paragrafi i parë, pas fjalëve “...i drejtohet me një kërkesë me shkrim...” fjalët “Drejtorisë së Përgjithshme Detare”, zëvendësohen me fjalën “Ministrisë”.... dhe pas fjalëve “...për kryerjen e një inspektimi...” fjala “teknik” zëvendësohet me fjalët “të përgjithshëm”...

c) Shtohet paragrafi i dytë me përmbajtjen: “Pas marrjes së kërkesës, ministri urdhëron ngritjen e një grupi pune për verifikimin e kushteve të përgjithshme të anijes dhe të operimit të sajë në një linjë, rast pas rasti”.

d) Te paragrafi i tretë, pas fjalëve “Pas përfundimit të inspektimit...” fjalët “Drejtoria e Përgjithshme Detare do t’i lëshojë subjektit një vërtetim” zëvendësohen me fjalët “Grupi i punës harton një relacion të detajuar në përfundim të të cilit do të shprehet”, pas fjalës “kriteret...” fjala “teknike” zëvendësohet me fjalën “të përgjithshme”, pas fjalëve “do të...” fjala “dërgojë Ministrisë” zëvendësohet me fjalën “paraqesë ministrit”.

2. Në nenin 10 “Kontrata me Portin/terminalin portual” bëhen këto ndryshime:

a) Te paragrafi i parë, fjala “Pas...” zëvendësohet me fjalën “Para...”;

b) Te pika 3, pas fjalëve “operimit të...” fjalët “mjetit lundrues” zëvendësohen me fjalët “mjetit/mjeteve lundrues/lundruese”;

c) Shtohet pika 7 me përmbajtjen: “Deklarimin e operatorëve për respektimin e orareve në nisje/mbërritje nga/në portet nga mjeti/mjetet lundrues/lundruese objekt licencimi, si dhe të përgjegjësive monetare ndaj udhëtareve/ transportuesve për vonesa të pajustificuara nga autoritetet shtetërore si policia kufitare dhe migracionit, shërbimi doganor dhe kapiteneria e portit.

3. Në nenin 13 “Zëvendësimi, shtesa ose prekjet shtesë të mjetit lundrues në një linjë të miratuar” bëhen këto ndryshime:

a) Te pika 1 pas fjalës “Udhëzimi,...” fjalët “i kërkohet Drejtorisë së Përgjithshme Detare kryerja”, zëvendësohen me fjalët “i bëhet kërkesë Ministrisë për kryerjen” dhe pas fjalës “inspektimit.” shtohen fjalët “të kushteve të përgjithshme të mjetit lundrues.”;

b) Te pika 2, pas fjalës “lundrues...” të shtohen fjalët “të shpejtësive të larta”.

4. Termi QKL dhe QKR, zëvendësohen sipas legjislacionit në fuqi me termin e unifikuar QKB.

5. Në nenin 17 “Dispozita tranzitore dhe të fundit”

Lejet e dhëna sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4, datë 21.5.2015, “Për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre”, të jenë në përputhje me kërkesat e ndryshimeve të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Sokol Dervishaj